

RAPORT MONITORIMI

Përmbledhje

Hartimi i strategjisë kombëtare
ndërsektoriale për
decentralizimin dhe qeverisjen
vendore (2015 – 2020)





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

RAPORT MONITORIMI

PËRMBLEDHJE

**HARTIMI I STRATEGJISË
KOMBËTARE NDËRSEKTORIALE PËR
DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN
VENDORE (2015 – 2020)**

Maj 2015

Financuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Ky dokument u përgatit në kuadër të projektit “Monitorimi dhe Vlerësimi i Procesit të Decentralizimit në Shqipëri” financuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri. Analiza, vlerësimet dhe rekomandimet janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë opinionin e Ambasadës së Zvicrës.

Autorët:

Shfqet Bruka
Marsela Dauti
Kadri Gega
Sabina Ymeri

Kontribuan:

Fation Dragoshi
Orsiola Kurti
Aleka Papa

© IDM 2015

Të gjitha të drejtat e Autorit. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose të ndryshohet pa miratimin paraprak të autorëve.

www.idmalbania.org

Përmbajtja

Hyrje	4
Dokument Politikash nr. 1	6
Dokument Politikash nr. 2	9
Dokument Politikash nr. 3	11
Dokument Politikash nr. 4	13
Përmbledhje ekzekutive e gjetjeve të analizës së procesit të hartimit dhe përmbajtjes së SKNDQV	16
Rekomandimet e ekspertëve nga analiza e strategjisë	22
Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore (2015 – 2020)	26

Hyrje

Njësitë vendore në Shqipëri kanë hyrë në një fazë të re zhvillimi. Një sërë reformash kombëtare synojnë t'i transformojnë ato në qendra të zhvillimit politik, ekonomik, dhe social. Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) (2015 – 2020) është një nga instrumentet përmes të cilit qeveria shqiptare synon ta realizojë një gjë të tillë. Kjo strategji është përballë dy sfidave kryesore: (a) të adresojë problemet që kanë karakterizuar decentralizimin në Shqipëri gjatë 15 vitevetë fundit; dhe (b) të paraqesë hapa konkrete përmes të cilave decentralizimi realisht do të çojë në forcimin e njësisve vendore në Shqipëri. Por a do të çojë strategjia e propozuar në forcimin e qeverisjes vendore? Si e perceptojnë strategjinë zyrtarët vendorë dhe qendrorë? A do të çojë strategjia në një përsëritje të problemeve që kanë karakterizuar decentralizimin gjatë 15 viteve të fundit apo në një shkëputje prej tyre?

Për të adresuar këto pyetje, grupi i ekspertëve në Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim monitoroi procesin e hartimit të SKNDQV (2015 – 2020). Monitorimi u fokusua në tre dimensionet e decentralizimit – politik, administrativ, dhe financiar. Ekspertët ndoqën procesin e hartimit të strategjisë nga afër duke ndjekur takimet e grupeve dhe nëngrupeve të punës si dhe komunikimet midis tyre. Njëkohësisht, ekspertët analizuan përmbajtjen e drafteve të strategjisë për të kuptuar ndryshimet në kohë; nivelin në të cilin përmbajtja e strategjisë i është përgjigjur ndryshimeve të propozuara nga grupet e interesit. Një element thelbësor i analizës ishte edhe shqyrtimi i perceptimeve të zyrtarëve në nivelin qendror dhe vendor. Raporti sjell perspektivat e aktorëve të ndryshëm duke vënë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Gjetjet tregojnë se procesi i hartimit të strategjisë së decentralizimit është karakterizuar nga një kombinim zhvillimesh – pozitive dhe negative. Për shembull, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe stafi i tij krijuan ura komunikimi me të zgjedhurit vendor, shoqërinë civile dhe ekspertët për përmirësimin e procesit të hartimit si dhe përmbajtjes së strategjisë së decentralizimit. Megjithatë, ka munguar bashkëpunimi mes pozitës dhe opozitës. Apo, strategjia përcakton disa synime ambicioze në fushën e kompetencave. Megjithatë, ajo nuk arrin të qartësojë ushtrimin e kompetencave të plota për çështjet vendore në juridiksionin e qeverisjes vendore. Njëkohësisht, studimi tregon se zyrtarët janë skeptikë dhe mosbesues në lidhje me përmbushjen e objektivave të strategjisë. Në mënyrë të veçantë, impakti i strategjisë në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale mbetet i dyshimtë për zyrtarët vendorë.

Qëllimi i këtij raporti nuk është thjesht të paraqesë gjetje, por të inkurajojë individë, grupe, apo organizata të përfshira në fushën e qeverisjes vendore në Shqipëri t'i përdorin gjetjet me qëllimin fuqizimin e njësive vendore: njësitë vendore të kenë autonominë dhe kapacitetet e duhura për të nxitur zhvillimin dhe bashkëpunimin midis tyre.

Dokument Politikash

nr. 1

Drejt De-Centralizimit?

Një analizë e mjedisit mundësues për decentralizimin në Shqipëri

Shqipëria ka një mungesë të theksuar të traditës së qeverisjes së decentralizuar. Përvoja qeverisëse gjatë dekadës së parë të sistemit demokratik liberal deri në vitet 2000 përbën valën e parë të decentralizimit. Në vitin 1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se “qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”. Nenet 108-115 tek pjesa e gjashtë e Kreut IV të Kushtetutës përcaktojnë nivelet e autoriteteve të qeverisjes vendore, ngritjen dhe funksionimin e tyre si dhe të drejtat dhe funksionet kushtetuese. Nën këtë frymë të decentralizimit, Parlamenti i Shqipërisë ratifikoi Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në nëntor të vitit 1999, që garanton zbatimin e standardeve evropiane në kuadrin ligjor kombëtar. Ligji Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, miratuar në 31 korrik të vitit 2000, përbën ligjin organik, që udhëheq funksionimin e autoriteteve vendore të nivelit të parë dhe të dytë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe u miratuan ligje me rëndësi të veçantë, si Ligji Nr. 8743 dt. 22.02.2001, “Për Pronat e Paluajtshme”, Ligji Nr. 8744 dt. 22.02.2001, “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore Njësive të Qeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 9636 dt. 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

Vala e dytë e decentralizimit sapo ka nisur dhe lidhet ngushtësisht me rikonfigurimin territorial të vendit sipas reformës administrative-territoriale. Pavarësisht se në programin elektorale të qeverisë parashikohej një rrugë e njëkohshme midis reformës administrative-territoriale dhe reformës së decentralizimit, realisht u ndoq një qasje sekuenciale ku

përpos riorganizimit territorial po përvijohet me decentralizimin.

Dokumenti analizoi prirjet e përgjithshme të mjedisit në të cilin po zhvillohej decentralizimi politik, administrativ dhe financiar në Shqipëri. Argumentet u paraqitën nën dritën e valës së dytë të decentralizimit, specifikisht hartimit të Strategjisë Ndër-Sektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020 dhe rishikimit të ligjeve kryesore me ndikim në qeverisjen vendore.

Në pjesën e fundit të dokumentit u dhanë rekomandimet e mëposhtme me synim përmirësimin e mjedisit sipas parimit të subsidiaritetit dhe autonomisë vendore, për të tre dimensionet:

- Nevojitet të ndërmerren disa masa dhe ndryshime ligjore që nëpërmjet zgjedhjeve të arrihet pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike të qeverisjes vendore (përfaqësimi nuk duhet të jetë poshtë 30 %);
- Rishikimi i procedurës ligjore për zgjedhjen e Këshillit të Qarkut është i nevojshëm për të siguruar një përfaqësim të drejtë;
- Përcaktim i pragut minimal për përfaqësimin në këshillat vendor dhe përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në bashkitë me mbi 200 mijë banorë;
- Rishikimi i ligjit organik dhe garantimi i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në periudhën jashtë zgjedhore për: (i) planifikimin me pjesëmarrje, (ii) buxhetimin me pjesëmarrje, (iii) përzgjedhjen dhe vendosjen e përparësive, (iv) trajtimin e nismave qytetare (v) ndërtimin e politikave vendore, dhe (vi) pjesëmarrje në monitorim dhe vlerësim;
- Ridimensionim i misionit, rolit dhe funksioneve të strukturës drejtuese komunitare në kushtet e riorganizimit territorial të vendit;
- Formalizimi i procesit të konsultimit të qeverisjes qendrore dhe vendore në përputhje me Rekomandimin nr. 349 për Shqipërinë të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.
- Përcaktimi i standardeve kombëtare për shërbimet, që janë nën përgjegjësinë e funksioneve ekskluzive për njësitë e qeverisjes vendore;
- Ripërcaktimi i qartë i funksioneve të përbashkëta dhe rishikimi i funksioneve të nivelit të mesëm të qeverisjes për të shmangur mbivendosje institucionale me institucionin e prefektit dhe autoritetet e dekoncentruara;

- Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor për funksionet ekskluzive apo të përbashkëta të NJQV-ve në respekt të hierarkisë ligjore dhe parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore.
- Përcaktimi i një objekti të qartë mbi përqindjen e rritjes së të ardhurave të qeverisjes vendore në raport me të ardhurat e përgjithshme publike në Shqipëri;
- Madhësia e transfertës së pakushtëzuar nevojitet të shprehet si përqindje e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit;
- Ndryshimet në burimet e të ardhurave të veta për njësitë e qeverisjes vendore nevojiten të konsultohen paraprakisht me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;
- Zbatimi i taksave të ndara, si taksa mbi të ardhurat personale (TAP) apo tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) ndihmojnë në ekualizimin vertikal;
- Renta minerare kërkohet të transferohet në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore përkatëse në respekt të ligjit Nr. 10304 dt.15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- Rishikimi i formulës së ekualizimit për transfertën e pakushtëzuar për të lehtësuar ekualizimin horizontal.

Dokument Politikash

nr. 2

Sfidat e demokracisë në nivel vendor

Një vështrim analitik mbi Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000, ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore’”

Konsolidimi territorial i Shqipërisë përmes reformës administrative-territoriale dhe miratimi i Ligjit Nr. 115/2014 datë 31/07/2014 “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” solli nevojën e ndryshimeve në kuadrin ligjor që udhëheq organizimin dhe veprimtarinë e qeverisjes vendore. Qeveria, nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, propozoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin organik, të cilat u konsultuan me shoqatat e të zgjedhurve vendorë, aktorë të shoqërisë civile dhe donatorët që mbështesin proceset reformatore në nivel vendor.

Këto ndryshime të propozuara shtrinin disa pikëpyetje në lidhje me demokracinë. Elementët më të rëndësishëm të demokracisë sipas Dahl janë barazia politike dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Demokracia vendore udhëhiqet prej parimeve të demokracisë përfaqësuese dhe pjesëmarrëse, që ushtrohet në nivel vendor. Ndërkohë që demokracia përfaqësuese lidhet me proceset zgjedhore dhe politikën vendore, demokracia pjesëmarrëse e vë theksin tek pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe e grupeve të interesit, që ndikojnë politikën vendore.

Ky dokument i dytë politikash në mbështetje të reformës së decentralizimit analizoi ndryshimet ligjore të propozuara në ligjin organik në raport me demokracinë, duke u ndalur veçanërisht në mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies vertikale, siç janë

zgjedhjet, marrëdhëniet ndër-institucionale ashtu edhe në mekanizmat e përgjegjshmërisë horizontale siç është ndarja dhe kontrolli i pushtetit dhe pjesëmarrja qytetare.

Në pjesën e fundit të dokumentit u dhanë rekomandimet përkatëse:

- Ofrim i një përkufizimi të qartë të konsultimit (Neni 2) dhe ndarje konceptuale midis konsultimit, informimit dhe shkëmbimit;
- Përcaktim i procedurave dhe i standardeve minimale të konsultimit dhe normimi i tyre në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore. Nevojitet detajim në ligjin organik në vend të akteve nën-ligjore mbi strukturën, formën, mënyrën e organizimit, funksionimit, natyrën e çështjeve për diskutim dhe frekuencën kohore;
- Ndryshim i sistemit të zgjedhjeve vendore nga sistem proporcional i mbyllur në sistem pro-porcional gjeografik, që siguron një përfaqësim më të lartë të interesave të qytetarëve dhe zonave periferike dhe rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje;
- Njohja si e drejtë ekskluzive e qeverisjes vendore e përcaktimit të strukturave administrative dhe krijimi i nëndarjeve administrativo-territoriale sipas nevojave vendore me qëllim rritjen e efikasitetit;
- Rishikimi i Nenit 44/1 ku statusi i Administratorit të njësisë administrative nevojitet të jetë si nëpunës civil në vend të emërimit politik të kryetarit të bashkisë;
- Funkzioni i miratimit të strukturës organizative dhe rregulloreve bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi nevojitet të mbetet në tagrin e këshillit bashkiak për të siguruar kontrollin e pushtetit;
- Parashikim i dispozitave që rregullojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje.
- Ridimensionimi i strukturave nënbashkiake komunitare me mision, fushë veprimtarie, mënyrë zgjedhjeje në ligjin organik.

Dokument Politikash

nr. 3

Monitorimi i procesit të hartimit të strategjisë së decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2014-2020

Ky dokument i tretë i politikave synonte paraqitjen e nivelit në të cilin qeveria ishte e hapur gjatë procesit të hartimit dhe diskutimit të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale së Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2014-2020. Dokumenti u organizua sipas dimensioneve të ndjekura gjatë punës monitoruese, specifikisht transparencës, pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit. Përzgjedhja e këtyre tre dimensioneve bazohej në literaturë si dhe në parimet që udhëheqin marrëdhënien e qeverive të vendeve të zhvilluara me publikun.

Në pjesën e fundit të dokumentit u dhanë rekomandimet përkatëse:

- Publikimi i dokumenteve strategjike, studimore, raporteve dhe analizave të zhvilluara në kuadër të hartimit të strategjisë me qëllim përmirësimin e transparencës dhe rritjen e për-fshirjes së aktorëve, publikut dhe grupeve të tjera në proceset decentralizuese.
- Publikimi i versionit anglisht të draft-strategjisë;
- Angazhim më i plotë i grupit ndër-institucional të punës për përfundimin e procesit të hartimit të strategjisë. Përcaktimi i një afati të pranueshëm dhe i arritshëm nga të gjithë shihet si rrugë që sjell bashkërendim dhe mobilizim më të mirë institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm;
- Grupi i punës/nëngrupet të organizojnë tryeza dhe debate me

ekspertë, aktorë dhe grupe interesi për të përcjellë tek publiku përmbajtjen, objektivat, prioritetet, përfitimet dhe rrugët e realizimit të strategjisë. Kjo do të sjellë një rritje të transparencës dhe ndërgjegjësim të publikut për fuqizimin e qeverisjes vendore nëpërmjet decentralizimit;

- Një rol më i ndjeshëm i të gjitha shoqatave të të zgjedhurve vendore do të rriste nivelin e pjesëmarrjes në kuadër të hartimit të strategjisë pavarësisht pozicionit politik të bashkive dhe komunave;
- Gjetja e rrugëve dhe rritja e besimit reciprok me qëllim përfshirjen e gjithë faktorit politik në procesin e hartimit të strategjisë për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri të strategjisë.
- Përcaktimi i procedurave, afateve dhe mënyrave të konsultimit;
- Diskutim i hapur me fokus (i) rekomandimet për Shqipërinë të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale (rekomandimit 201 [2006] dhe të rekomandimit 349 [2013], (ii) rekomandimet e Misionit të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e datës 8 Maj 2011 si dhe (iii) të Komisionit Evropian të shprehura në raportet e progresit;
- Sugjerohet përfshirja në procesin e hartimit të strategjisë të deputetëve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike/ Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore dhe kërkuesve shkencorë me qëllim marrjen e mendimit dhe kontributit të ligjvënësve si dhe vlerave shkencore nga kërkuesit;
- Harmonizimi i strategjisë së decentralizimit me strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale është domosdoshmëri.

Dokument Politikash

nr. 4

Strategjia e decentralizimit 2014 – 2020: Perceptimet e aktorëve vendorë dhe qendrorë

Pas publikimit të dy versioneve paraprake të Draft-Strategjisë nga Grupi Ndërinstitucional i Punës për Hartimin e SKNDQV dhe përfundimit të procesit formal të konsultimit, shqyrtimi i perceptimit të aktorëve të interesit në lidhje me strategjinë dhe procesin hartimit të saj paraqet interes të veçantë. Si e perceptojnë palët e interesuara përmbajtjen e strategjisë? Po procesin e hartimit dhe konsultimit të strategjisë? Cili do të jetë ndikimi potencial i strategjisë në njësitë e qeverisjes vendore?

Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të decentralizimit në Shqipëri, IDM ndërmori një fushatë për matjen e perceptimit të zyrtarëve vendorë dhe qendrorë si dhe të palëve të tjera të interesit mbi procesin e hartimit dhe përmbajtjen e strategjisë së decentralizimit. Ky dokument politikash i katërt prezantoi gjetjet kryesore të këtij hulumtimi. Dokumenti prezantonte gjetjet moduleve përmbajtësore ku orientohet matja e perceptimit dhe përkatësisht: 1) Aksesit në informacion dhe njohuritë rreth strategjisë; 2) Përmbajtja e strategjisë; 3) Transparenca e qeverisë qendrore; 4) Pjesëmarrja në hartimin e strategjisë; dhe 5) Ndikimi.

Metodologjia

Matja e perceptimit rreth procesit të hartimit dhe përmbajtjes së strategjisë së decentralizimit u realizua me anë të kombinimit të teknikave kërkimore sasiore dhe cilësore. Pjesa sasiore konsistoi në dy anketa që iu drejtuan zyrtarëve vendorë dhe aktorëve qendrorë duke shfrytëzuar një kampionim të volitshëm. Pyetësi i parë iu drejtua

zyrtarëve vendorë dhe përkatësisht: kryetarëve të bashkive/komunave, kryetarëve të këshillit bashkiak/komunal dhe drejtuesve në fushën e financës ose shërbimeve. Kampioni përfundimtar u përbë nga 60 individë të shpërndarë gjeografikisht në të 12 qarqet e Shqipërisë (norma e përgjigjeve = 35%). Në total, kampioni përfshin 75% burra dhe 25% gra. Mbitotërojnë drejtuesit në fushën e financës/shërbimeve (55%) të ndjekur nga kryetarët e bashkive/komunave (21%). Bashkitë përfaqësojnë 68% të kampionit, ndërsa komunat 32%. Në lidhje me orientimin politik, rreth 54% e kampionit mund të konsiderohet me orientim politik të djathtë, krahasuar me rreth 46% të kampionit me orientim të majtë.³ IDM arriti të sigurojë një balancim të tillë politik në kampionin që i përket aktorëve vendorë edhe pse e djathta ka qenë disi e distancuar nga procesi i hartimit dhe konsultimit të strategjisë së decentralizimit. Ndërkohë, pyetësi i dytë iu drejtua aktorëve qendrorë dhe përkatësisht: nëpunësve të ministrive të linjës, shoqatave të qeverisjes vendore, komunitetit të donatorëve dhe agjencive të ndryshme, shoqërisë civile dhe deputetëve të Kuvendit (anëtarë të Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore). Kampioni u përbë nga 30 aktorë të nivelit qendrorë (norma e përgjigjeve = 34%). Ky kampion paraqitet më i ri, më i mirë-arsimuar dhe më i balancuar nga pikëpamja gjinore krahasuar me kampionin e zyrtarëve vendorë.

Pjesa cilësore e hulumtimit konsistoi në gjashtë fokus grupe 5 të organizuara në Kukës, Lezhë, Elbasan, Durrës, Fier dhe Tiranë. Në fokus grupe u ftuan përfaqësues të qeverisjes vendore (Komuna, Bashki dhe Këshilla Qarqesh) dhe institucioni i prefektit nga të 12 qarqet e Shqipërisë, shoqatat e të zgjedhurve vendorë, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe ekspertë të qeverisjes vendore. Kampioni përfshin në total 48 aktorë dhe shfaqet i balancuar nga pikëpamja gjinore dhe përkatësia politike. Të dhënat sasiore u shqyrtuan duke kombinuar elemente të natyrës përshkruese dhe relacionale. Ndërkaq, të dhënat cilësore u analizuan duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes.

Në pjesën e fundit të dokumentit u dhanë rekomandimet përkatëse.

- Përmirësimi i aksesit në informacion. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore duhet të ketë në vëmendje shpërndarjen e informacionit rreth Strategjisë në të gjitha njësitë vendore. Edhe Shoqata e Bashkive, ajo e të Zgjedhurve Vendorë, dhe Shoqata e Komunave duhet të luajnë një rol aktiv në shpërndarjen e këtij informacioni.
- Rritja e njohurive rreth përmbajtjes së strategjisë. Tre aspekte janë të rëndësishme: (a) të rriten njohuritë rreth përmbajtjes aktuale të strategjisë; (b) të sigurohen detaje të mëtejshme rreth mënyrës si do të ndahen funksionet midis dy niveleve – qendror dhe vendor – në praktikë. Njësitë vendore presin zbatimin e parimit të vetëqeverisjes nëpërmjet subsidiaritetit dhe marrjen e autoritetit për të gjitha çështjet vendore. Gjithashtu, presin të

kenë më shumë autonomi fiskale me strategjinë e re, edhe pse ka shumë skepticizëm nëse kjo do të ndodhë në realitet dhe c) të ketë më shumë detaje rreth instrumenteve dhe mekanizmave që do të realizojnë përmbushjen objektive strategjike të Strategjisë.

- Rekomandohet përmirësimi i mekanizmave aktualë dhe krijimi i mekanizmave të rinj të transparencës në lidhje me shkëmbimin e informacionit, konsultimit dhe ndarjen e fondeve dhe granteve.
- Qartësimi i funksioneve të qarkut. Rekomandohet qartësimi i rolit, funksioneve dhe burimeve financiare të qarkut.

Përmbledhje ekzekutive
e gjetjeve të analizës së
procesit të hartimit dhe
përmbajtjes së **SKNDQV**

Ky raport fokusohet në monitorimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) (2015 – 2020). Ai mbështetet në analizat e ekspertëve si dhe perceptimet e aktorëve në nivelin qendror dhe vendor. Më poshtë është një përmbledhje e gjetjeve kryesore të monitorimit. Gjetjet janë grupuar në dy seksione: (a) procesi i hartimit të strategjisë; dhe (b) analiza e strategjisë.

Procesi i hartimit të strategjisë

- Procesi i hartimit të SKNDQV u udhëhoq nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore me asistencën e USAID/PLGP dhe me kontributin e agjensive dhe programeve që punojnë në fushën e qeverisjes vendore.
- Që nga muaji dhjetor 2014 strategjia dhe plani i veprimit (shqip dhe anglisht) u publikuan në faqen zyrtare të MSHÇV duke iu krijuar mundësi grupeve të interesit, ekspertëve dhe çdo qytetari të interesuar të konsultohet me përmbajtjen e saj.
- Takimet e grupit të punës dhe tryezat e organizuara për këtë qëllim ishin të hapura dhe u raportuan gjerësisht nga media e shkruar dhe audiovizive. Takimet u publikuan në faqen zyrtare të MSHÇV, PLGP/USAID dhe DLDP. Takimet e nëngrupeve të punës, duke qenë diskutime teknike, kanë qenë të mbyllura.
- Dokumentat, raportet dhe analizat që u vendosën në dispozicion të grupit të punës dhe nëngrupeve mbulojnë gjithë problematikat e qeverisjes vendore, sfidat me të cilat ajo ndeshet si dhe synimet për të ardhmen.
- Afatet për hartimin e strategjisë janë ndryshuar disa herë.
- Pjesëmarrja në grupin ndërinstitucional të punës konsiderohet gjithëpërfshirëse. Edhe pse pjesë e grupit të punës, jo të gjithë shoqatat e të zgjedhurve vendor morën pjesë në takimet e grupit të punës.
- Janë evidente përpjekjet dhe angazhimet serioze të MSHÇV dhe të stafit të tij për të siguruar një bashkëpunim efektiv me ministrinë e linjës, donatorët, programet në fushën e qeverisjes vendore, institucionet e dekoncentruara, njësitë e qeverisjes vendore, shoqatat e të zgjedhurve vendor dhe shoqërinë civile.
- Një vlerë të shtuar të bashkëpunimit MSHÇV dhe stafi i tij arritën të sigurojnë nëpërmjet programeve PLGP/USAID dhe DLDP të cilët në zonat e tyre arritën të krijojnë ura komunikimi dhe bashkëpunim efektiv me të zgjedhurit vendor, shoqërinë civile dhe ekspertë

duke prodhuar sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit të hartimit e të përmbajtjes së strategjisë.

- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qendror njohu edhe probleme që kishin të bënin me disa vonesa nga ministritë e linjës për të dhënë kontributet e tyre në kohë gjatë procesit.
- Bashkëpunimi me shoqatat e të zgjedhurve vendor herë pas here shfaqti probleme që vinin kryesisht nga mungesa e bashkëpunimit mes faktorëve politikë.
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë i mirë dhe gjithëpërfshirës.
- Bashkëpunimi me IDM, si organizatë e shoqërisë civile që po monitoronte procesin e hartimit të strategjisë ka qenë i mirë, i hapur dhe me kontribute të ndërsjella për të përmirësuar procesin dhe përmbajtjen e strategjisë.

Analiza përmbajtësore e strategjisë

- Strategjia shpreh një synim ambicioz për përfaqësimin gjinor “rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe grave në këshillat vendor me deri në 50% të përbërjes së këshillave”. Me nismën e një grupi deputetesh, ky synim u materializua me shtesën që iu bë pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, përfaqësimi gjinor në këshillat vendor ka marrë një dimension të ri shumë pozitiv.
- Mënyra e zgjedhjes së këshillit të qarkut shkakton pabarazi përfaqësimi dhe nuk është në përputhje me parimin “votim i barabartë”/fuqi e barabartë e votës. Zgjidhja që ka bërë ligji nr. 30/2015, datë 31.7.2000 përfaqësimin në këshillin e qarkut nuk është në një linjë me rekomandimet 201 (2006) dhe 349 (2013) të Kongresit.
- Pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Kjo është evidentuar në përmirësimet në përmbajtje që ka pësuar kjo çështje gjatë procesit të hartimit të strategjisë si dhe me miratimin e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
- Strukturat komunitare vlerësohen si të dobishme dhe me rëndësi për përmirësimin e demokracisë vendore, minimizimin e efekteve potencialisht negative të sistemit të konsoliduar territorial, plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

- Gjatë periudhës së tranzicionit, marrëdhëniet mes dy niveleve të qeverisjes kanë qenë gjithnjë në përmirësim. Gjatë kësaj periudhe marrëdhëniet janë shoqëruar edhe me probleme dhe kanë pasur ulje ngritje për shkak të mungesës së përvojës së bashkëpunimit, konflikteve politike, klimës së mosbesimit dhe mungesës së rregullimit me ligj të këtyre marrëdhënieve. Në strategji marrëdhëniet ndërqeveritare janë trajtuar mirë. Përshkruhet mënyra se si do të përmirësohen këto marrëdhënie, përcaktohet formalizimi me ligj i procesit të konsultimit dhe jepet angazhimi i qeverisë “Asnjë vendim që ndikon në qeverisjen vendore nuk do të merret pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore”.
- Ligj Nr. 30/2015, datë 2.4.2015, ligjëron për herë të parë procesin e konsultimit dhe kjo është një gjë shumë pozitive. Pavarësisht nga kjo, ligji mbart disa problematika që lindin nga fakti se Këshilli i Ministrave është caktuar si autoriteti që përcakton strukturën, formën, mënyrën e organizimit, funksionimin, natyrën e çështjeve për konsultim dhe frekuencën kohore të procesit të konsultimeve mbi këtë bazë kanë lindur dyshimet se qeveria ruan kontrollin mbi konsultimin.
- Gjatë periudhës së tranzicionit, kompetencat e qeverisjes vendore në disa raste nuk janë të përcaktuara qartë, ka mbivendosje, nuk janë të plota dhe ka probleme në lirinë e ushtrimit të tyre. Strategjia përcakton disa synime ambicioze në fushën e kompetencave, në lidhje me funksionet e përbashkëta. Këto synime lidhen me qartësimin, rishikimin, harmonizimin dhe eliminimin e mbivendosjes së kompetencave.
- Strategjia nuk arrin të qartësojë përfundimisht ushtrimin e kompetencave të plota për çështjet vendore/çështjet publike në juridiksionin e qeverisjes vendore. Ajo nuk i shmanget dot konfuzionit të krijuar nga terminologjia kompetenca “të veta” dhe “të deleguara” dhe funksione “të veta” dhe “të deleguara”.
- Strategjia ka përshkruar mirë dhe ka përcaktuar qartë objektivat dhe masat që do të ndërmerren për reformën administrativo-territoriale dhe zbatimin e saj. Në versionin përfundimtar të planit të veprimit ka një përmirësim rrënjësor në krahasim me versionin e tetorit 2014. Nga dy masa që kishte në versionin e tetorit 2014, sot kemi një kapitull “I. Reforma Administrativo-Territoriale” dhe 10 masa që përfshijnë të gjithë elementët e zbatimit të reformës territoriale.
- Krijimi i “Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale” me qëllim mbështetjen e njësisve të reja të qeverisjes vendore është një veprim pozitiv.

- Strategjia përshkruan mirë qëllimin, objektivat specifike dhe masat për strukturat përfaqësuese, ekzekutive dhe komunitare. Pas 31 dhjetorit 2017, bashkitë e reja marrin kompetencën e plotë të riorganizimit administrativ sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative dhe kjo shkon në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Kartës Evropiane.
- Rreth 30% e masave të parashikuara në planin e veprimit lidhen me konsolidimin e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore. Që në fillim grupi i punës, duke parë rëndësinë e këtij komponenti, ngriti nëngrupin tematik “Strukturat dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale”, i cili ka bërë një punë shumë të mirë.
- Në Partneritetin Publik Privat (PPP) në nivel vendor është qartësuar fusha e bashkëpunimit, por mbetet e paqartë se çfarë lloj kompetencash do të ushtrohen nga palët.
- Në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, gjendja paraqitet tejmasë e vështirë në menaxhim dhe kërkon ndërhyrje emergjente afatshkurtër dhe ndërhyrje afatgjatë - jo vetëm “afatmesme” siç shprehet në strategji.
- Në sektorin e shërbimeve sociale dhe të përkujdesit shoqëror, do të ishte me shumë vlerë nëse do të përcaktohej më parë masa e financimit të këtij funksioni nga buxheti i shtetit, pra vlera në shifra e shportës e pastaj ndërhyrja nga buxhetet vendore.
- Në sektorin e strehimit social, roli i Komitetit Kombëtar të Strehimit nuk është përcaktuar qartë pasi nga funksioni konsultues ky komitet është veshur me autoritet vendimmarrës, veprim që cënon apo mbivendoset me kompetencat e qeverisjes vendore.

Rekomandimet e ekspertëve

nga analiza e strategjisë

- Ridimensionimin territorial të vetëqeverisjes rajonale (qarkut) dhe plotësimin dhe qartësimin e kompetencave, funksioneve, burimeve të tij në bazë të parimit të “subsidiaritetit, kohezionit territorial dhe besnikërisë”.
- Zgjidhjen e problemit të pabarazisë në përfaqësim në këshillat e qarqeve.
 - o Si hap të parë, të shpejtë, dhe pa ndryshime kushtetuese, rekomandojmë gjetjen e një formule të përshtashme përfaqësimi me bazë numrin e pupullsisë.
 - o Si hap përfundimtar, ne rekomandojmë ndryshime kushtetuese nëpërmjet të cilave të sigurohet që vetëqeverisja rajonale të ushtrohet nga këshilli i qarkut me anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal.
- Rregullime në kuadrin ligjor, në statutet dhe rregulloret e funksionimit të këshillave bashkiakë për të siguruar pjesëmarrjen aktive qytetare në vendimmarrje. Nëpërmjet këtyre rregullimeve duhet:
 - o të përcaktohen qartësisht dimensionet e çështjeve, i pjesëmarrjes, territorial, financiar, gjinor dhe social.
 - o të ridimensionohen strukturat administrative që lehtësojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive.
 - o të përcaktohen standardet minimale detyruese për informimin, konsultimin, dëgjuesin periodike publike, iniciativat qytetare, peticionet dhe komisionet qytetare. Gjithashtu, në këtë kuadër rekomandohet ratifikimi i protokollit shtesë të Kartës Evropiane për të drejtën për pjesëmarrje në punët e një

organi vendor.

- Ndryshime në dispozitat ligjore për referendumet vendore me qëllim që ai të jetë një instrument qeverisës i arritshëm dhe i përdorur nga qytetarët dhe në përputhje me traditën më të mirë evropiane.
- Ridimensionim i strukturës drejtuese komunitare (ndërlidhësit) duke përfshirë përcaktimin e misionit, fushës së veprimtarisë së tyre (funksionet dhe kompetencat), mënyrës së zgjedhjes, burimet financiare dhe marrëdhëniet dhe ndërveprimet me institucionet e tjera publike e komunitare.
- Ridimensionim ligjor të marrëdhënive mes autoriteteve vendore dhe qendrore duke pasur si bazë parimet e vetëqeverisjes, subsidiaritetit, ligjshmërisë, diskrecionit dhe të delegimit të kompetencave dhe instrumentat e bashkëpunimit, informimit, konsultimit, mbikqyrjes dhe kontrollit ligjor. Në këtë kuadër, rekomandohet që me ligj të përcaktohen procedurat dhe standardet minimale të konsultimit. Gjithashtu, me ligj të përcaktohet struktura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimin, çështjet për konsultim dhe afatet kohore të procesit të konsultimeve.
- T'u garantohet me ligj njësisive të qeverisjes vendore liria e plotë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre dhe të ushtrojnë kompetenca të plotë për funksionet ekskluzive.
- Sugjerohet shqyrtimi dhe një diskutim i hapur i rekomandimeve për Shqipërinë të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale (rekomandimi 201 (2006) dhe rekomandimi 349 (2013)) dhe përfshirja e tyre në legjislacionin përkatës.
- Prodhimin e ujit, pra sistemet me bazë ujore, apo ato me shpime në thellësi, si edhe transportimin e tij nëpërmejt tubacioneve të mëdha kryesore e realizon më mirë qeverisja qendrore se ajo vendore. Qeverisja vendore nuk ka kapacitetet e duhura për ta realizuar këtë shërbim në të gjithë hallkat e zinxhirit të tij.
 - o Qeverisja vendore duhet të ketë kompetenca ekskluzive të veta për furnizimin me ujë të qytetarëve, duke e blerë atë nga një pikë depozitë e caktuar e në vazhdim ta shpërndajë atë në familje e biznese duke vendosur edhe sistemin e kontrollit për abuzime. Tarifat me këtë sistem bazohen tek kostot. Në këtë propozim, ka dy aktorë kryesorë: shitësi i prodhimit (qeverisja qendrore) dhe blerësi i ujit (qeverisja vendore). Bashkitë pasi blejnë ujin e menaxhojnë atë në mënyrë të pavarur dhe atëherë përgjigjen plotësisht përpara qytetarëve për realizimin e këtij shërbimi. Duhet shtuar se gradualisht duhet të fillojnë iniciativa për të lënë alternativë për të lejuar shitës të tjerë

privatë. Çmimi i ujit ulet në dy mënyra: konkurenca në tregun e blerjes së ujit nga ana e bashkive dhe menaxhimi i mirë i brendshëm përsëri nga ana e bashkive.

- Duhet të ketë vetëm një listë funksionesh të qeverisjes vendore dhe jo më shumë, e cila të quhet “funksionet e veta të qeverisjes vendore”. Edhe në funksionet e përbashkëta aktuale, edhe në ato të deleguara, kompetencat e ndara qartë midis qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Ato duhen përcaktuar si kompetenca të secilës palë vecmas ku të jepet qartë se ku fillojnë e mbarojnë kufijtë e njëjës palë lidhur me palën tjetër. Konsiderohet emergjencë e shkallës së lartë vendosja e standarteve në të gjitha fushat në të cilat kryen aktivitetin pushteti vendor.
- Ligji i ri organik duhet të hartohet në një mjedis konsensual me aktorë dhe faktorë të lidhur me zhvillimin në pushtetin vendor. Përfshirja e të zgjedhurve vendor dhe ekspertëve përkatës është detyrim për të realizuar hartimin e një ligji cilësor.
- Zhvillimi ekonomik lokal duhet të gjejë më tepër vend në legjislacionin e ardhshëm. Rekomandojmë planifikim ekonomik orientues me piketa të qarta për bashkitë e reja, sidomos ato që zotërojnë toka bujqësore. Planet e zhvillimeve ekonomike të territorit duhet të jenë të detyrueshme për t’u hartuar e zbatuar nga bashkitë e reja në të ardhmen.
- Sugjerohet që treguesit e matshëm për dimensionin financiar të strategjisë (pesha e shpenzimeve vendore ndaj PBB; raporti të ardhura të veta/të ardhura me burim kombëtar) të sqarohen më gjerësisht edhe në pjesën narrative të strategjisë për të shmangur keqkuptime të mundshme mbi nocionet e përdorura. Për shembull, do të ishte me interes të kuptohej nëse fondet nga FZHR, investimet direkte nga FZSH apo fondet e pritshme nga reforma e zhvillimit rajonal pritet të përlllogariten si shpenzime të veta të njëjësive vendore.
- Do të ishte me vend që strategjia të shprehej në mënyrë të qartë mbi synimin dhe metodën e pritshme të ndarjes së taksave kombëtare.
- Do të ishte me vend që strategjia të përcaktonte qartë synimin për të rritur nivelin e taksave të pasurisë, si një mënyrë e paevitueshme për të rritur eficientë e kësaj takse, si edhe për korrigjimin e pabarazive në barrën e kësaj takse në sistemin aktual.
- Në lidhje me transferat ekualizuese, do të ishte pozitive nëse strategjia do të shprehej mbi synimin ose jo për ndryshimin drastik të kriterëve në krahasim me sistemin aktual, përfshirë edhe synimin për të futur kriterë të reja (për shembull përbërja

demografike e cila kërkon strukturë të ndryshme shërbimesh e kostosh), baza për ekualizimin fiskal (për shembull kalimi drejt një baze tase më të qëndrueshme dhe më lehtë të llogaritshme siç mund të jetë taksa e pasurisë), apo shkalla e ekualizimit.

- Në lidhje me huamarrjen vendore, do të ishte me vend që strategjia të përcaktonte angazhimin për të miratuar kuadrin ligjor për paaftësinë paguese, duke marrë në konsideratë edhe mundësinë që huamarrja të mos jetë e lejueshme në mungesë të një auditimi paraprak të pavarur. Gjithashtu, do të ishte me vlerë t'i jepej përgjigje edhe çështjes së bashkëndarjes së kufirit të borxhit publik mes qeverisë qendrore dhe atyre vendore, në përpjesëtim me pjesën që shpenzimet e tyre kanë në shpenzimet publike të konsoliduara.

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore (2015 – 2020)

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të SKNDQV-së janë identifikuar të tillë që të mund të lejojnë krahasimin e Shqipërisë me vendet në rajon por edhe të reflektojnë situatën e njësive vendore. Me hartimin e treguesve krijohet mundësia e monitorimit të strategjisë në kohë. Të dhënat që do të grumbullohen para zbatimit të strategjisë do të shërbejnë si bazë. Në këtë mënyre mund të matet impakti i decentralizimit – ndryshimet që ai do të sjellë në kohë.

Tabela e paraqitur më poshtë përfshin një sërë treguesish të cilët janë të ndarë në pesë grupe. Përveç ndarjes tradicionale të decentralizimit – fiskal, administrativ, dhe politik – ne kemi përfshirë edhe dy dimensione të tjera – llogaridhënia vertikale dhe horizontale.¹ Për secilën formë decentralizimi do i jepet vëmendje katër fushave: autoriteti, kapacitetet, përgjegjësitë, dhe informacioni.² A do të çojë strategjia e re e decentralizimit në forcimin e autoritetit, kapaciteteve, përgjegjësisë dhe aksesit në informacion të njësive vendore? Tabela 1 përfshin një sërë treguesish të cilët duhet të diskutohen më tej me qëllim identifikimin e burimeve të mundshme të informacionit. Matja e decentralizimit fiskal është më e drejtpërdrejtë se matja e decentralizimit politik dhe administrativ.

Tabela 1: Treguesit e decentralizimit³

	Treguesit	Burimi
Decentralizimi fiskal^{4,5}	<p>Të ardhurat vendore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ardhurat vendore në raport me të ardhurat e qeverisë qendrore. • Të ardhurat vendore nga taksat në raport me të ardhurat e qeverisë qendrore nga taksat. • Të ardhurat vendore në raport me PBB. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Financave • Shoqata e Bashkive • Shoqata e Komunave • Analiza të institucioneve publike dhe private • Raporte të njësive vendore

1 Ideja e llogaridhënies vertikale dhe horizontale është mbështetur tek Velgel, K. Constructing indicators to measure and monitor decentralization in Sub-Saharan Africa.

2 Hutchinson P.L. & LaFond, A. K. (2004). Monitoring and evaluation of decentralization reforms in developing country health sectors.

3 Dy tema të tjera që u sugjeruan të përfshihen nga pjesëmarresit e aktivitetit të organizuar në 25 Korrik, 2014 janë a) situata sociale dhe ekonomike e komunitetit Rom, dhe b) regjistrimi i emigrantëve.

4 Network of Associations of Local Authorities of South East Europe. (2014). Fiscal decentralization: Indicators for South-East Europe, 2006 – 2012 (3rd edition).

5 World Bank. (2013). Decentralization indicators.

Treguesit	Burimi
<p>Shpenzimet vendore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpenzimet vendore në raport me shpenzimet e qeverisë qendrore. • Shpenzimet vendore për pagat në raport me shpenzimet e qeverisë qendrore për pagat. • Shpenzimet vendore në raport me PBB. <p>Shpenzimet funksionale vendore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpenzimet vendore ne sektorin e shendetesise ne raport me shpenzimet e qeverise qendrore ne sektorin e shendetesise. • Shpenzimet vendore në sektorin e arsimit në raport me shpenzimet e qeverisë qendrore në sektorin e arsimit. • (Përfshi sektorë të tjerë) <p>Ekuilibri vertikal</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ardhurat vendore në raport me shpenzimet vendore. • Të ardhurat vendore nga taksat në raport me shpenzimet vendore. • Të ardhurat nga transfertat në raport me të ardhurat vendore.⁶ • Huamarrja e qeverisë vendore në raport me huamarrjen e qeverisë qendrore. <p>Të tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësia e njësive vendore për të vjelur taksat. • Kapacitetet menaxhuese të njësive vendore. • Transparenca e formulës së transfertave ndërqeveritare. • Njohuritë e zyrtarëve vendor rreth formulës së shpërndarjes së transfertave ndërqeveritare. • Burimet e të ardhurave vendore dhe raporti me të cilin ato qendrojnë me njëra tjetrën. 	

6 NALAS (2014) përmend se 45% e të ardhurave të njësive vendore në Shqipëri përfitohen përmes granteve të kushtëzuara nga qeveria qendrore.

	Treguesit	Burimi
Decentralizimi administrativ	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli në të cilin rolet dhe përgjegjësite për realizimin e shërbimeve publike janë të qarta. • Niveli i delegimit të përgjegjësive në nivele të ndryshme qeverisjeje (p.sh. qarku dhe rajone). • Numri dhe lloji i funksioneve të njësive vendore për realizimin e shërbimeve publike. (P.sh. a është rritur numri i funksioneve? Cilat funksione (të veta, të deleguara, të përbashkëta)? A janë kaluar funksionet në kohë? • Prezenca e standarteve të shërbimeve publike. Zbatimi në praktikë. • Cilësia e shërbimeve publike (p.sh. shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtja e rrugëve). • Numri i projekteve të financuara nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike. • Numri i programeve të trajnimit të hartuara me qëllim forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve vendor. Numri i personave të trajnuar. • Numri i kurrikulave të hartuara dhe zbatuara nga organizatat ndërkombëtare. • Theksimi i evidencës shkencore për të informuar programet e ndërhyrjes në njësite vendore. • Prezenca e konflikteve ligjore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Administratës Publike • Ministria e Integritit • Organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare

	Treguesit	Burimi
Decentralizimi politik	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i autonomisë së autoriteteve vendore. • Niveli i shpërndarjes së përgjegjësive nga qeveria qendrore në ato vendore. • Cilësia e zgjedhjeve lokale. • Niveli në të cilin qeveria qendrore është transparente rreth akteve që kanë lidhje me njësitë vendore. • Niveli në të cilin qeveria qendrore përfaqëson interesat vendore. • Cilësia e ndërveprimit midis banorëve dhe zyrtarëve vendor. • Përqindja e grave këshilltare. • Përqindja e grave që punojnë në institucionet publike. • Niveli i tensioneve politike midis qeverisë qendrore dhe vendore. • Përcaktimi i prioritetëve i mbështetur në evidencë shkencore. • Niveli i njohurisë së zyrtarëve të lartë rreth situatës lokale. • Kapaciteti i zyrtarëve vendor për të hartuar dhe zbatuar plane lokale. • Numri i personave të larguar nga puna me ndryshimet politike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizat e organizatave kombetare dhe nderkombetare • Komisioni Elektorale • Open Government Partnership • EMA • Transparency International • Vendimet e Gjykatës për personat e hequr nga puna

	Treguesit	Burimi
Llogaridhënia horizontale	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i nismave të ndërmarra nga njësite vendore me qëllim përmirësimin e qeverisjes vendore dhe transparencës. • Realizimi i buxhetimit me pjesëmarrje. Numri i grupeve të konsultuara gjatë buxhetimit me pjesëmarrje. • Niveli i njohurisë së qytetarëve me punën e zyrtarëve vendor. • Numri i qytetarëve që shprehen të kënaqur me qeverisjen vendore në raport me popullsinë e njësisë vendore. • Numri i njësive vendore që po zbatojnë programe të qeverisjes elektronike. Aksesi i banorëve në programet e qeverisjes vendore. • Monitorimi dhe auditimi i njësive vendore. Rezultatet. • Mekanizma të adresimit të ankesave të njësive vendore dhe zbatimi i tyre në praktikë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Njësitë e Qeverisjes Vendore • Ministria e Financave • Organizatat kombëtare dhe nderkombëtare • USAID / PLGP
Llogaridhënia vertikale	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i programeve për rritjen e kapaciteteve të njësive vendore, llojet e programeve, dhe zbatimi i tyre në praktikë. • Dhënia e informacionit të mjaftueshëm njësive vendore për të adresuar kërkesat e tyre. • Promovimi i një kulture bashkëpunimi njësi vendore dhe qendrore. • Ekzistenca e një sistemi transparence për shpërndarjen e investimeve dhe granteve dhe zbatimi i tij në praktikë. 	

MONITORING REPORT

Summary

On drafting the National
Crosscutting Strategy for
Decentralization and Local
Governance (2015 – 2020)





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

MONITORING REPORT

SUMMARY

**ON DRAFTING THE NATIONAL
CROSSCUTTING STRATEGY FOR
DECENTRALIZATION AND LOCAL
GOVERNANCE (2015 – 2020)**

May 2015

Funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

This document was prepared in the framework of the Monitoring and Evaluation of Decentralization Process in Albania Project funded by the Embassy of Swiss Confederation in Albania. The analysis, evaluations and recommendations are of the authors and do not necessarily represent the opinions of the Embassy of Swiss Confederation.

Authors:

Shefqet Bruka
Marsela Dauti
Kadri Gega
Sabina Ymeri

Contributors:

Fation Dragoshi
Orsiola Kurti
Aleka Papa

